



VENDIM

Nr. 144, Datë 25.08.2016

MBI

**MIRATIMIN E KONTRATËS TIPPËR SHITBLERJE TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NDERMJETSHOQËRISË SË PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE, AKSIONET E SË CILËS
KONTROLLOHEN PLOTËSISHT OSE PJESËRISHT NGA
SHTETI/KESH SH.A DHE FURNIZUESIT TË SHËRBIMIT
UNIVERSAL OSHEE SH.APËR PERIUDHËN 01.07.2016 – 31.12.2016.**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 20 gërma "h" të Ligjit nr. 43/2015, datë 22.05.2003, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike"; 5 dhe 14 të VKM Nr.244 dt. 30.03.2016 "Per miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike" dhe nenit 26 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr 96 date 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 25.08.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit në lidhje me miratimin e kontratës për shitblerje të energjisë elektrike ndermjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti/ KESH sh.a dhe Furnizuesit të shërbimit universal OSHEE sh.a. per furnizimin e klienteve fundor për periudhën 01.07.2016 – 31.12.2016.

Konstatohet se :

- Këshilli I Ministrave ka miratuar vendimin Nr. 244 date 30.03.2016 "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike".
- Në nenin 5 të VKM Nr. 244 date 30.03.2016 parashikohet se :Furnizuesit e Shërbimit Universal, për të përmbushur kërkesat e klientëve që përfitojnë nga Shërbimi Universal I Furnizimit, në përputhje me parashikimet e pikës 1, të nenit 109, të ligjit nr.43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", I vendoset detyrimi I shërbimit public për të blerë sasinë e nevojshme të energjisë elektrike, të prodhuar nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti.

Sasia e energjisë elektrike përcaktohet në kontratën e rregulluar ndërmjet palëve, që miratohet nga ERE, bazuar në një regjim racional shfrytëzimi të kapaciteteve gjeneruese dhe nivelit historic mesatar vjetor të prodhimit.

- Ne nenin 14 te VKM nr. 244 date 30.03.2016, parashikohet se: *Këto rregulla do të sberbejne si model i përkohshem per funksionimin e tregut te energjise elektrike, deri ne miratimin e Modelit te Tregut te Energjise Elektrike, ne perputhje me Ligjin nr. 43/2015 "Per sektorin e energjise elektrike". Enti Rregullator i Energjise brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të miratojë aktet përkatëse për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në këto kushte.*

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE :

Vendosi:

1. Miratimin e Kontratës për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti/ KESH sh.a dhe Furnizuesit të shërbimit universal OSHEE SH.A. përfurnizimin e klienteve fundor për periudhën 01.07.2016 – 31.12.2016. (bashkelidhur)
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë OSHEE sh.a dhe KESH sh.a, për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.